



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:146249

Datë: 17.05.2021

Numri i dokumentit: 01784750

C.nr.1015/19

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Gëzim Shehu, çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.P., nga Prizreni, të cilin e përfaqëson me autorizim av. M.Q., nga Prizreni, kundër të paditurit Ndërmarrja “Euro Invest”, SH.P.K me seli në Prizren, në rrugën “.....” Prizren, t..... cilin e përfaqëson Drejtori I.J., nga Prizreni, me objekt të padisë vërtetimit i të drejtës së pronësisë, pas mbajte se shqyrtimi kryesor publik, me datën **17.05.2021** mori këtë:

A K T G J Y K I M

Në bazë të pohimit

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit Sh.Gj., nga Prizreni.

II. VËRTETOHET se i njëjti në bazë të shitblerjes ka fituar të drejtën e shfrytëzimit nënqiramarrje prej 99 vite në njësinë kadastrale - banesore nr., në ZK Prizren, që gjendet në kompleksin afaristo-banesor Euro Centër, me sipërfaqe të përgjithshme prej **99 m2** (bruto), dhe detyrohet i padituri që ta pranojë këtë fakt dhe që të lejojë regjistrimin e kësaj paluajtshmërie në emër të paditësit si shfrytëzuese nënqiramarrje prej 99 vite, pranë Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Prizrenit, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi Shpejtim Gjinovci nga Prizreni, të cilin e përfaqëson me autorizim av. M.Q., nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë kundër të paditurit Ndërmarrja “Euro Invest” Sh.p.k - Prizren, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë.

Në seancën e shqyrtimit kryesorë i autorizuar i të paditurës I.J., nga Prizreni, 17.05.2021, ka deklaruar se nuk e konteston kërkesëpadinë e paditësit dhe se të njëjtën e pohon në tërësi si të bazuar, është e vërtetë se i njëjti e ka shitur banesën kontestues paditësit, i njëjti e ka paguar në tërësi çmimin e saj dhe është në posedim të saj.

Me nenin 148 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se “*Në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë*”

pjesërisht apo tërësisht, gjykata jep pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykim në bazë të pohimit)”.

Andaj duke u bazuar në nenin 148 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet gjykata e mori duke u bazuar në nenin 449 dhe 452 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1015/2019, datë 17.05.2021

G j y q t a r i,

Gëzim Shehu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve pas ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate. Bazuar në nenin 181.2 të LPK-së, ky aktgjykim mund të goditet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkakut se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin eventuale të dhunës apo mashtrimit.